

Fjala e Kryetarit të ASH, Akademik Skënder Gjinushit, në takimin me ekspertë rajonalë të sizmikës.

Të nderuar pjesëmarrës,

Ju uroj mirëseardhjen në këtë takim pune të organizuar nga Akademia e Shkencave.

Është një kënaqësi e nder për ne që ju keni pranuar të merrni pjesë në këtë takim konsultativ rajonal e ndërinstytucional për probleme aktuale të sizmikës dhe mbrojtjen nga tërmetet, nëpërmjet ndërtimeve rezistente e të qëndrueshme konform standardeve evropiane, e forcimit të atyre ekzistuese. Fillimisht do të dëshiroja të prezantoja pjesëmarrësit duke filluar nga më të largët. Itali, Greqi, Mal i Zi Kosovë, Shqipëria: zëvendësministri Artan Shkreli, Rektori, zv, rektori, dekani, zv/shefi, shefi i departamentit, njësia jonë prof. Shyqyri Aliaj, akademikë e anëtarë të Komisionit të inxhinierisë pranë ASH. Siç dihet Shqipëria përjetoi dy tërmete të fuqishme të njëpasnjëshme, i dyti me forcë shkatërrimtare. Ato ishin një dëshmi e asaj, që njihet prej kohësh, prej specialistëve e qendrave sizmologjike të rajonit e më gjerë që territori ynë është një territor i kërcënuar me një rrezikshmëri të lartë të përjetimit të goditjeve sizmike me fuqi mbi 6, të shkallës Riter, çka shoqërohet me shkatërrime e dëme materiale e deri njerëzore.

Instituti ynë i Gjeologjisë e Sizmologjisë, në bashkëpunim edhe me homologë të rajonit, ka kryer ndër vite, një sërë studimesh në këtë drejtim ku kryesori është ai i paraqitur nga profesorët tanë të nderuar Shyqyri Aliaj, Siasi Koçiu, Betim Muço dhe Eduard Sulstarova.

Ndodhitë më të fundit vërtetuan edhe një herë saktësinë shkencore të studimeve, duke treguar se tërmetet vërtet nuk mund të parashikohen me ditë, orë apo muaj, por periodiciteti i tyre është i parashikueshëm, shkalla e forca e rrezikut sipas zonave është e parashikueshme, sjellja e territoreve dhe ndërtesave janë të parashikueshme, e për rrjedhojë, edhe minimizimi i dëmeve e shkatërrimeve, evitimi i humbjeve të rënda njerëzore janë të parandalueshme nëpërmjet studimeve më të thelluara, zbatimit të tyre, disiplinimit të ndërtimeve bazuar në Eurokodet e normat e reja.

Tërmetet e fundit, e pasojat e tyre treguan edhe një herë nevojën e mbështetjes së Institucioneve shkencore në këto fusha si dhe forcimit të bashkëpunimit midis tyre me homologët rajonal si dhe domosdoshmërinë e bërjes detyrues të zbatimit të rezultateve të tyre.

Tërmeti i fundit shtroi dy detyra kryesore: një ndaj qeverisë për rimëkëmbjen dhe rindërtimin e zhdukjen e pasojave; e dyta ndaj institucioneve kërkimore e shkencore, inst., fakult., për thellimin

e studimeve dhe nxjerrjen e akteve për garantimin e adaptimit të Eurokodit në ndërtimet e reja dhe forcimin e ekzistueseve.

ASH mbështetur në studimin e profesorëve të nderuar,, në faktin se ende tek ne punohet me studime të mëparshme, se ende standardet Europiane në ndërtim nuk janë bërë detyrues me ligj, si pjesë edhe e Komitetit të Rindërtimit, ka ngritur një njesi me prof. Shyqyria Aliaj, në drejtim.

Qëllimi është mundësimi i bërjes efektiv e detyrues të rezultateve të arritura, për ngritjen e standardit kombëtar për projektimin e strukturave rezistente ndaj tërmetit bazuar në Eurokodet.

Sigurisht futja e plotë e Eurokodeve është një proces më i gjerë e kërkon bashkëpunim e përfshirjen e të gjithë institucioneve kryesore të vendit.

Prandaj krahas mbështetjes për punën e njësisë, ne dëshirojmë të luajmë një rol koordinues të këtë ndërmarrje të madhe të përbashkët, jo vetëm me institucionet tona, por në bashkëpunim edhe me ato të rajonit, të cilat duhen falënderuar për gatishmërinë e treguar deri më tani, në ndihmën e dhënë për përballimin e situatës së pas tërmetit. Jemi të bindur se ky vullnet do të shprehet edhe për bashkëpunimin e mëtejshëm. Pikërisht për ta bërë këtë bashkëpunim sa më të konkretizuar e sa më të frytshëm, në konsultim edhe me disa prej jush mendohet të zhvillohet një konferencë pune me tematikë sipas projektit të shpërndarë. Qëllimi është që të përcaktohen sa më qartë detyrat e çdo institucioni, studimet, aktet që duhen kryer në mënyrë që të jemi sa më të përgatitur për çdo ngjarje në të ardhmen.

Për këto arsye e zhvillojmë këtë takim, ku pas paraqitjes së punës së njësisë, nga prof. Aliaj, se cilat duhet të jenë hapat e masat për futjen e Eurokodit 8, jeni të lutur e mirëpritur për të kontribuar në mendimet e përvojat tuaja e veçanërisht në lidhje me nevojën e një konference të përbashkët në tetor 2020, tematikën e saj, modalitetet, përbërjen e komitetit organizativ.